



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Nr. 106/24  
Data. 06-02-24



Prishtinë, 29 janar 2024  
Kodi i ZRRE-së: V\_1870\_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenin 25, Nenit 26 dhe nenin 42 paragrafi 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Nenit 8 paragrafët 1, 2, 4, 8 dhe 11 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Dispozitat e Rregullës Nr. 03/2020 dhe Metodologjisë për Përgatitjen e Bilanceve të Energjisë;
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) Nr. 2202, të datës 01/11/2023 për shqyrtim dhe aprovim të Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike për vitin 2024,

në seancën e mbajtur me datë 29 janar 2024, nxori këtë:

## V E N D I M

- I. APROVOHET - Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike për vitin 2024.
- II. Zyra e Rregullatorit për Energji do të monitoroj implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë elektrike si në dispozitivin nën pikën I. të këtij Vendimi, për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në Bilanc.

## A r s y e t i m

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme ZRRE) me datë 01.11.2023 ka pranuar nga operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (në tekstin e mëtejme KOSTT Sh.A.), kërkesën për aprovim të Bilancit Vjetor i Energjisë Elektrike 2024.
- o Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike paraqet planin vjetor të shpenzimit të energjisë elektrike në raport me energjinë elektrike në dispozicion. Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike bazohet në nevojat e planifikuara të konsumit të energjisë elektrike për vitin 2023, i cili është parashikuar të furnizohet nga gjenerimi vendor dhe importi i energjisë elektrike. Po ashtu në bilanc parashikohet edhe eksportimi i tepërcave të energjisë elektrike.
- o Qëllimi kryesor i Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike është që të projektojë përmbushjen e nevojave të konsumatorëve me energji elektrike, në sasi të mjaftueshme gjatë vitit, duke angazhuar kapacitetet e prodhimit dhe transmetimit në mënyrën sa më të mirë tekniko-



ekonomike.

- Ministria e Ekonomisë ka paraqitur mendimin Nr. prot. 3959 të datës 25.10.2023 për draft dokumentin, ku kanë paraqitur komentet dhe propozimet e tyre në dokumentin përkatës, të cilat i kanë dorëzuar në KOSTT SH.A.
- Bordi i ZRRE-së, pas shqyrtimit të Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike 2024 ka kërkuar që të bëhen ndryshimet në lidhje me:
  - a. Planifikimin e Revizioneve të TC Kosova A nga 10 ditë sa është propozuar nga KEK, kërkohet të bëhet për 8 ditë, kurse Planifikimin e Revizioneve të TC Kosova B nga 7 ditë sa është propozuar nga KEK, kërkohet të bëhet për 6 ditë.
  - b. Planifikimin e kërkesës neto në OSSH për konsumatorët familjar me rritje prej 0.5 % krahasuar me vitin paraprak dhe rreth 2% për konsumatorët jo-familjar.
- Bordi i ZRRE-së, ka vlerësuar se duhet të bëhet rishikimi dhe azhurnimi i nevojshëm me kërkesat e reja si më lartë, sa i përket revizioneve dhe parashikimit për energji, sepse konsideron që rritja e kërkesës siç është paraparë nga palët nuk është e arsyeshme. Ndërsa sa i përket revizioneve, kërkon nga KEK që të bëhen përpjekje maksimale që këto revizione të kryhen brenda periudhës së cekur më lartë.
- ZRRE konsideron se janë përmbushur kriteret për aprovim, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.




Vendimet i bashkëngjitet dokumenti:

- Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2024


**Bordi i ZRRE-së:**




Ymer Fajzullahu, kryesues



Lutfije Dervishi, anëtare



Gani Buçaj, anëtar



Arta Qoroll, anëtare



Adrian Preniqi, anëtar

Vendimi i dërgohet:

- KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji